

Dembelët e "Hasan Prishtinës"

Monitorohen Filozofiku, Juridiku dhe Ekonomiku

Nga 86 profesorë të monitoruar nga Fakulteti Juridik, Ekonomik dhe Filozofik, 34 kanë munguar në 100% të termineve të caktuara për konsultime.

*Punë, punë natë e
ditë që të shohim
pakëz dritë.*



?!



VERITAS VOS LIBERABIT!

(E vërteta do t'ju bëjë të lirë)

Ky titull u drejtohet studentëve. Ideali që keni krijuar në mendjen tuaj për universitetin para se të pranoheni në të, është vetëm një mendim i bukur prapa të cilit fshihet realiteti fatal. Ju nuk keni salla. Ju nuk keni profesorë. Ju nuk keni libra. Ju nuk keni lëndë. Shkollimi juaj është një improvizim. Suksesi juaj varet nga aftësitë tuaja autodidaktike. Juve nuk ju pret puna, por papunësia. Ose migrimi.

Kjo e vërtetë do t'ju bëjë të lirë. Ju duhet ta rimendoni pozicionin tuaj. Ju nuk mund të prisni në mëshirën e fatit që fatal do të jetë për të gjithë ne. Për shoqërinë kosovare.

Ky titull i drejtohet shoqërisë sonë. Universiteti i Prishtinës nuk është "tempulli i dijes", është bunker i mosdijes. Ne të gjithë, në dekadat që po vijnë do të jemi siç është universiteti ynë sot. Ne mbase do të mund të lëvizim të lirë e pa viza, por horizonti i ngushtë i mendjeve tona është bunkeri izolues që më shumë sesa mungesa e lirisë për lëvizje, na bën neve robër të mosdijes.

Kjo e vërtetë do t'na bëjë të lirë nga shpresa ëndërrimtare se diku, dikur do të shfaqet prodhimi shpëtimtar i Universitetit historik. E vërteta është që ky universitet do të prodhojë mendje të ngushta, të diplomuar të padijshëm, errësirë intelektuale e fatalizëm akademik.

Universiteti dominohet nga profesorë që nuk i justifikojnë titujt akademikë që mbajnë. Më tepër se kaq, janë arrogantë. Nuk mbajnë ligjëratat me rregull, nuk mbajnë konsultime me rregull. Vijnë e shkojnë, të pakontrolluar. Hyjnë e dalin, të papërgjegjshëm. Kolegët e tyre të rregullt e të devotshëm ndaj detyrës i lënë në hije me bëmat e tyre negative.

Ky titull u drejtohet edhe profesorëve. Ka përfunduar koha e errësirës së informacioneve rreth jush. Tashmë ne, me ndihmën edhe të akademikëve ndërkombëtarë, e dimë. E dimë punën tuaj të pretenduar shkencore. E dimë sa herë mbani konsultime e sa herë jo. Sa herë vini në ligjëratat e sa herë jo, dhe shumë shpejt do t'ju tregojmë të gjithëve. Sepse e vërteta do t'na bëjë të lirë. Të lirë nga idealizimet për ju dhe uni-

versitetin tonë. Të lirë nga paragjykimet për pastërtinë e punës profesoriale. Të lirë nga iluzioni. Të lirë për të rivendosur rolin tonë si shoqëri në bërjen e Universitetit që i shërben shoqërisë si institucion i dijes e jo grupeve si agjensi punësimi nepotik.

Ne nuk jemi armiq të askujt. Ne jem mik i secilit që synon shoqëri ku vlerë është debati dhe tabuja nuk ekziston. As për punën e profesorit të hyjnizuar pa meritë. Ne nuk synojmë asgjë tjetër, veç universitetit të fortë publik dhe cilësisë së arsimit.

Shoqëria jonë duhet t'i japë fund epokës në të cilën rrojmë që një kohë të gjatë. Epokës së rrenave për veten tonë. Mendësisë e cila synon ruajtjen e imazhit e jo të institucionit. Mendësisë e cila kritikën për universitetin e sheh armiqsore siç e shihnin diktaturat disidencën. Ne nuk mund të rrejme më. Ne duhet ta themi të vërtetën për veten tonë, për universitetin tonë, për profesorët tanë ashtu që të mund të përmirësohemi e t'i përmirësojmë ata.

E vërteta do t'na bëjë të lirë.

HYRJJE

Si pasojë e ankesave të studentëve në vazhdimësi dhe raportimeve të mediave në Universitetin e Prishtinës, ORCA ka vendosur të hulumtojë disa aspekte të mbarëvajtjes së mësimdhënies në Universitet.

ORCA ka monitoruar tri Fakultetet me fluksin më të madh të studentëve në UP: Fakultetin Filozofik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Juridik. Gjatë muajit prill, ORCA ka monitoruar mbajtjen e konsultimeve sipas orareve zyrtare të këtyre fakulteteve. Konsultimet, zakonisht rregullohen me rregulloret e brendshme të fakulteteve, por në rastet e këtyre tre fakulteteve kjo rregullore nuk ekziston.

Neni 65, pika 4 e Statutit të Universitetit të Prishtinës thotë që "Këshilli drejtues nxjerr rregullore mbi organizimin e brendshëm të njësive akademike me propozim të këshillit të njësive akademike përkatëse"¹. Këshillet e fakulteteve Filozofik, Ekonomik dhe Juridik nuk e kanë zbatuar detyrën e tyre të paraparë me statut për përpilimin e rregulloreve të brendshme.

Gjithashtu sipas Statutit të UP-së, neni 185, pika 1.4,

thuhet se personeli akademik obligohet të respektojë aktet universitare dhe vendimet e bazuara në to². Personeli akademik i monitoruar nga ORCA ka dështuar në respektimin e vendimit 2/901³, që thotë se orari i punës në Universitetin e Prishtinës është nga 08:00-16:00, ndërkohë që shumë nga profesorët e monitoruar kanë munguar në konsultimet që supozohen t'i mbajnë gjatë orarit të punës.

Në Rregulloren për masat disiplinore ndaj personelit akademik të Universitetit të Prishtinës e cila ka hyrë në fuqi me 11.04.2015, në nenin 5 pika 1.1 parashihet si shkelje e lehtë rasti ku profesori ka tri mungesa të paarsyeshme me kohëzgjatje njëditore.

Hulumtimi e vë në pah mosrespektimin e orarit të punës nga një pjesë e madhe e stafit akademik. Organet menaxhuese të njësive akademike duhet të fillojnë procedurat për shqiptimin e masave dhe ndalesat e mëditjes apo pagesave të tjera të para me Rregulloren për të Ardhurat Personale.

Po ashtu duhet parë mundësia që shkelësve të

rregullave shtëpiake t'u mohohet përfshirja në komisionet vlerësuese për tri vitet vijuese ashtu sikurse parashihet në nenin 8 pika 1 dhe 2 e Rregullores për Masat për shkeljet disiplinore.

Sipas të gjeturave të hulumtimit tonë, nga 31 profesorë të Fakultetit Filozofik, 18 prej tyre kanë munguar në 100% të termineve të monitoruara, dhe vetëm një ka munguar në më pak se gjysmën e termineve. Në Fakultetin Juridik, nga 15 profesorë të monitoruar 6 kanë munguar në 100% të termineve të monitoruara, dhe vetëm 3 profesorë kanë munguar në më pak se gjysmën e termineve të monitoruara. Në Fakultetin Ekonomik, nga 40 profesorë të monitoruar, 10 kanë munguar në 100% të rasteve, dhe 16 kanë munguar në më pak se gjysmën e termineve të monitoruara.

1 Statuti i Universitetit të Prishtinës

2 Po aty.

3 www.uni-pr.edu

<http://www.uni-pr.edu/getattachment/20412319-045c-4a7e-8b52-85aae9e49719/Vendim---Percaktimi-per-njeren-page-apo-vend-pune-.aspx>

METODOLOGJIA

OBJEKTI I HULUMTIMIT

Përzgjedhja e objekteve të hulumtimit (Fakultetit Filozofik, Ekonomik dhe Juridik) është bërë në bazë të numrit të studentëve dhe ngarkesës që ato kanë, parë nga raporti i numrit të profesorëve dhe studentëve.

Po ashtu është marrë parasysh që një numër i konsiderueshëm i profesorëve të këtyre fakulteteve kanë angazhime të tjera publike.

Janë monitoruar vetëm profesorët të cilëve u ka figuruar emri në derën e zyrës apo të cilët kanë CV të publikuar në faqen e fakultetit përkatës.

KOHA E MONITORIMIT

Monitorimi i konsultimeve është bërë përgjatë muajit prill të vitit 2017, nga data 3 deri në datën 21.

METODA E HULUMTIMIT

Janë caktuar monitorues për secilin fakultet të monitoruar të cilët kanë mbajtur evidencë individuale për të gjithë stafin akademik me grada profesoriale (profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt). Është monitoruar puna e 86 profesorëve. Ky numër përfshin vetëm ata që kanë shpallur në dyert e tyre orare për konsultime.

Janë parë informatat lidhur me oraret e konsultimeve të secilit, në formë elektronike të shpallura në uebfaqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës si dhe informatat fizike të shpallura në dyert e zyrave të profesorëve. Fakultetet e monitoruara nuk e kanë pasur të publikuar në uebfaqen zyrtare të UP-së orarin e konsultimeve, edhe pse janë të obliguara sipas një njoftimi të datës 30.10.2015 i cili, thotë se "të gjitha njësitë akademike obligohen që t'i publikojnë në uebfaqet e tyre... orarin e konsultimeve të stafit akademik"⁴.

MBËSHTETJA LIGJORE

Vendimi i Këshillit Drejtues me Nr. 2/901⁵ i datës 13 tetor 2016 përcakton që orari i punës në UP për personelin akademik është 08:00 – 16:00.

SHMANGIE METODOLOGJIKE

ORCA e ka pasur të pamundur ta vërtetojë mbajtjen e konsultimeve në orare të tjera si zëvendësim për mungesat. ORCA nuk paragjykon mundësinë e mbajtjes së konsultimeve në një orar tjetër në marrëveshje me studentët në rastet kur profesorët kanë munguar.

4 [www.uni-pr.edu
http://www.uni-pr.edu/getattachment/f8dfdabd-24b2-467c-97f0-176b5ff94299/Njoftim-per-njesite-akademike-te-UP--Hasan-Prishti.aspx](http://www.uni-pr.edu/getattachment/f8dfdabd-24b2-467c-97f0-176b5ff94299/Njoftim-per-njesite-akademike-te-UP--Hasan-Prishti.aspx)

5 [www.uni-pr.edu
http://www.uni-pr.edu/getattachment/20412319-045c-4a7e-8b52-85aae9e49719/Vendim---Per-caktimi-per-njeren-page-apo-vend-pune-.aspx](http://www.uni-pr.edu/getattachment/20412319-045c-4a7e-8b52-85aae9e49719/Vendim---Per-caktimi-per-njeren-page-apo-vend-pune-.aspx)


REZULTATET E MONITORIMIT

FAKULTETI FILOZOFIK:

Nga 31 raste të monitoruara nga ORCA, 12 profesorë (38%) kanë në dyert e tyre të caktuara nga dy orë për konsultime, 12 profesorë (38%) kanë nga 4 orë të caktuara për konsultime, 6 profesorë (19%) kanë nga 5 orë të caktuara për konsultime, dhe një profesor konsideron se për konsultime mjafton vetëm një orë në javë.

25 profesorë (80%) nga 31 profesorë sa janë

monitoruar gjithsej, kanë munguar në (70-100)% të termineve të monitoruara; 18 nga 31 profesorët me më së shumti mungesa kanë munguar në 100% të termineve të monitoruara. 5 profesorë (16%) kanë munguar në (50-70)% të termineve të monitoruara, ndërsa vetëm një profesor ka munguar në më pak se gjysmën e termineve të monitoruara.



- Mungesë në (70-100)% të termineve
- Mungesë në (50-70)% të termineve
- Mungesë në më pak se gjysmën e termineve

1. Pasqyrimi i të dhënave nga monitorimi i konsultimeve në Fakultetin Filozofik


FAKULTETI EKONOMIK:

I gjithë stafi akademik prej 40 profesorësh, të qashtëm për hulumtuesit e ORCA-s, e kanë orarin e konsultimeve të shkruar në derën e zyrës të tyre. 2 profesorë (5%) kanë të parapara vetëm 1 orë për konsultime, 5 profesorë (12%) kanë parapara 2 orë për konsultime, 1 profesor ka parapara 2.5 orë për konsultime, 12 profesorë (30%) i kanë parapara nga 3 orë konsultime, 1 profesor i ka parapara 3.5 orë për konsultime, 18 profesorë (45%) i kanë 4 orë të parapara për konsultime, dhe një profesor i ka parapara 6 orë për konsultime.

Nga 40 profesorët e monitoruar, 18 (45%) kanë munguar në (70-100)% të termineve

të monitoruara, ku 10 nga ta kanë munguar në 100% të termineve; 6 profesorë (15%) kanë munguar (50-70)% të termineve të monitoruara, ndërsa 16 profesorë (40%) kanë munguar në më pak se gjysmën e termineve të parapara.

Gjatë monitorimit në Fakultetin Ekonomik, është vërejtur fenomeni i zyrave të përbashkëta të profesorëve të cilët kanë edhe oraret e njëjta të konsultimeve. Në një rast, dy profesorë kanë orare të konsultimeve në të njëjtën kohë; të dy këta profesorë kanë munguar në 100% të termineve të monitoruara.



- Mungesë në (70-100)% të termineve
- Mungesë në (50-70)% të termineve
- Mungesë në më pak se gjysmën e termineve

2. Pasqyrimi i të dhënave nga monitorimi i konsultimeve në Fakultetin Ekonomik


FAKULTETI JURIDIK:

Në ueb faqen e Fakultetit Juridik konsultimet përmenden vetëm te njoftimi "Pyetjet e Shpeshta" ku thuhet se orari i konsultimeve mund të gjendet te syllabuset e profesorëve. Në bazë të hulumtimit të ORCA-s, shumica e syllabuseve kanë përmbajtur vetëm normën e orëve të konsultimeve, dhe jo edhe orarin e saktë të tyre.

Nga 37 profesorë që gjenden në listën zyrtare të stafit akademik në Fakultetin Juridik, 21 profesorë (55%) nuk e kanë të caktuar orarin për konsultime. 3 profesorë (7%) kanë caktuar 4 orë për konsultime, 1 profesor ka caktuar 3 orë konsultime, 1 profesor ka caktuar 2.5 orë konsultime, 6 profesorë (15%) kanë caktuar nga 2 orë konsultime, 3 profesorë (7%) kanë

caktuar nga 1 orë konsultime, një rast ka të caktuar vetëm gjysmë ore në javë për konsultime dhe një rast tjetër orarin e konsultimeve e ka në "kohën e ligjëratave" ose gjatë pushimeve "sipas marrëveshjes".

Sipas hulumtimit të ORCA-s, nga 15 profesorë të monitoruar 7 profesorë (46%) kanë munguar në (70-100)% të termineve të monitoruara, nga këta 7 profesorë 6 prej tyre kanë munguar në 100% të termineve të monitoruara. 5 profesorë (33%) kanë munguar në (50-70)% të termineve të monitoruara, ndërsa 3 profesorë (20%) kanë munguar në më pak se gjysmën e termineve të monitoruara.



3.1 Pasqyrimi i të dhënave për orarin e konsultimeve



3.2 Pasqyrimi i të dhënave nga monitorimi i konsultimeve në Fakultetin Juridik

REKOMANDIMET

Në bazë të të gjeturave të monitorimit, ORCA rekomandon:

- 1.** Këshilli Drejtues t'i urdhërojë këshillat e njësive akademike që t'i përpilojnë rregulloret e brendshme të të gjitha fakulteteve.
- 2.** Të standardizohen të gjitha faqet e fakulteteve dhe të përditësohen faqet e fakulteteve me informacione të reja.
- 3.** Të përpilohen dhe publikohen oraret e konsultimeve të të gjithë personelit akademik të çdo fakulteti në uebfaqen e Universitetit të Prishtinës
- 4.** Të mos grumbullohen orët e konsultimeve në një ditë të vetme, por të shtrihen përgjatë javës.
- 5.** Të respektohen oraret e caktuara për konsultimet dhe po ashtu të merren masa për mosrespektimin e tyre.
- 6.** Të respektohet Vendimin Nr. 2/901 të Këshillit Drejtues që i obligon profesorët të jenë në hapësirat e universitetit nga ora 8:00-16:00 sipas orarit zyrtar të punës.
- 7.** Në ndryshimet e ardhshme statutores të pamundësohet për stafin e rregullt akademik punësimi në institucione tjera publike e private, politike apo të shoqërisë civile. Neni 65, pika 4 e Statutit të Universitetit të Prishtinës thotë që "Këshilli drejtues nxjerr rregullore mbi organizimin e brendshëm të njësive akademike me propozim të këshillit të njësisë akademike përkatëse." Këshillet e fakulteteve Filozofik, Ekonomik dhe Juridik

ÇFARË ËSHTË ORCA?

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) është themeluar në vitin 2016 në Prishtinë.

1. Organizata është themeluar me qëllim të:

- a. kryerjes së hulumtimeve dhe analizave për çështje të arsimit në Kosovë
- b. krijimit të një pasqyre për gjendjen e arsimit në Kosovë
- c. ofrimit të rekomandimeve për institucionet relevante për përmirësimin e gjendjes së arsimit në Kosovë.

2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndër marrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

- a. të hartojë hulumtime dhe dokumente tjera në të cilat analizohet gjendja në arsim në Kosovë
- b. të organizojë tryeza, diskutime publike, aktivitete demokratike për rritjen e vetëdijesimit qytetar lidhur me arsimin në Kosovë
- c. të organizojë takime me institucione relevante kombëtare e ndërkombëtare për çështjen e arsimit në Kosovë.

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA është organizatë që do t'i zhvillojë të dy aspektet e veprimit të OJQ-ve të para para me ligjet e Kosovës. Një pjesë e madhe e punës do të bazohet në hulumtimin e botimeve në revista të dyshimta dhe në hulumtimin e rasteve të plagjiaturave.

Paralelisht, ORCA do të shtrihet në Universitetin e Prishtinës duke synuar krijimin e një mase kritike studentore dhe të profesorëve përmes organizimit të aktiviteteve me studentë dhe me stafin akademik për arritjen e qëllimeve të saj.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht edhe pikëpamjet e KFOS

Ky raport u mbështet nga:



www.orca-ks.org
info@orca-ks.org

"Simon Shiroka", H-11, Nr. 8, 10000 Prishtina, Kosova